



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	Pranuar rre dt. 16.07.2021
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-208

KËSHILLI DREJTUES

Prizren, 16.07.2021

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, 16.07.2021

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 17, paragrafit 1 dhe nenit 22, paragrafi 1, pika 1.6. të Statutit të Universitetit 'Ukshin Hoti' Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013 si dhe në bazë të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli Drejtues, duke vendosur në lidhje me anulimin e vendimit sipas referencës 01-159 të datës 19.05.2021, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.7.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **ANULOHE**t vendimi nr. ref. 01-159 i datës 19.05.2021 i Këshillit Drejtues të Universitetit "Ukshin Hoti".
- II. Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" e konsideron të arsyeshme kërkesën e zyrës së burimeve njerëzore për rekrutimin e stafit të ri administrativ. Kjo lëndë do trajtohet pas përmbushjes së kushteve ligjore për lejimin e procedimit të konkurseve për pozita të reja pune.
- III. **OBLIGOHEN** organet drejtuese të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 07/I-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe për faktin se Universiteti "Ukshin Hoti" ballafaqohet me një deficit buxhetor në kategorinë buxhetore paga dhe mëditje, kështu që vendimi i Këshillit Drejtues me nr. ref. 01-159 i datës 19.05.2021 është nxjerrur pa një të analizë dhe planifikim të mirëfilltë financiar nga ana e menaxhmentit lidhur me disponueshmerinë e fondeve financiare për pagesën e personelit të ri të rekrutuar.

Andaj, në kuptim të alinesë 1.5, paragrafi 1 të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme përbën rast për anulimin e vendimit të lartcekur nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti". Prandaj, në zbatim të dispozitave të lartcekura, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë konflikt administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë – departamenti për Çështje Administrative në afat prej 15 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

Këshillit Drejtues;
Menaxhmentit të Universitetit;
Sekretarit të Përgjithshëm;
Shërbimeve përkatëse të administratës dhe
Arkivit

Kryesues i Këshillit Drejtues


Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

